

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR, Nr. 160, Shtator 2022

Vështrim mbi tregjet

- Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Gusht 2022

Zhvillime të tjera

- Nis procesi i vlerësimit të Parimeve Themelore në Sigurime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare
- Konsultim publik për:
 - Projektregulloren "Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi"
 - Ndryshimet në rregulloren "Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit"

Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator: Monedhat dixhitale - mundësi për pagesat ndërkufitare
- OECD Vështrim ekonomik - shtator 2022

Informacione Ndërkombëtare

Bosnje-Hercegovinë
Mali i Zi

Greqi
Poloni

Hungari
Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Gusht 2022


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-gusht 2022 kapën vlerën 13,881 milionë lekë, ose 9.53% më shumë se në janar-gusht 2021. Gjatë periudhës janar-gusht 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 867,266 me një rritje prej 16.41% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.79% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.12%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.16% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.84% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-gusht 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,172 milionë lekë, ose 9.74% më pak se në periudhën janar-gusht 2021. Kjo ka ardhur kryesisht për shkak të vijimit të pagesave të dëmeve nga tërmetet e funditvitit 2019 përgjatë vitit 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-gusht 2022 kapën vlerën 2,857 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 7.94% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar–Gusht 2022 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-gusht 2022 kapën vlerën 2,857 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 7.94% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Nis procesi i vlerësimit të Parimeve Themelore në Sigurime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare



Procesi do të shërbejë për identifikimin e nevojave për përmirësime të mëtejshme të praktikave mbikëqyrëse, apo ndërmarrjen e ndryshimeve ligjore në fushën e sigurimeve.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) ka nisur procesin e vlerësimit të Parimeve Themelore në Sigurime (ICP) për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Në këtë kuadër, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete, priti në një takim ekipin e vlerësuesve të IAIS, ku u diskutua në lidhje me programin e punës dhe metodikën e realizimit të vlerësimit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit u shpreh se qëllimi i procesit është vlerësimi i plotë i progresit të bërë nga Autoriteti dhe përputhshmëria e bazës ligjore e rregullatore, si edhe praktikave mbikëqyrëse me standardet më të larta ndërkombëtare në sigurime. Ai theksoi se që prej vlerësimit të realizuar përmes Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) nga ana e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar në vitin 2013, janë ndërmarrë ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor e rregullator.

Përfaqësuesit e IAIS vlerësuan bashkëpunimin dhe gadishmërinë e shfaqur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë fazës së parë të vetëvlerësimit, dhe theksuan se procesi do të shërbejë për identifikimin e nevojave për përmirësime të mëtejshme të praktikave mbikëqyrëse, apo ndërmarrjen e ndryshimeve ligjore në fushën e sigurimeve.

Ekipi i vlerësuesve të IAIS do të realizojë një vlerësim të plotë të progresit të bërë në aspekte si pavarësia institucionale e mbikëqyrësit, praktikat mbikëqyrëse, vlerësimi dhe analizimi i riskut, baza ligjore, procedurat e licencimit, mbikëqyrja e grupeve të sigurimit, etj.

Në muajin prill 2022, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare aderoi në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në funksion të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve. Anëtarësimi i AMF-së në grupin e vendeve nënshkruese të MMoU-së u realizua pas një procesi rigoroz verifikimi të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me standardet ndërkombëtare të IAIS.



Konsultim publik:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=86>

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=87>

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren "Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren "Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi". Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik. <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=86>

AMF nxjerr për konsultim publik ndryshimet në rregulloren "Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka ndërmarrë disa ndryshime në rregulloren "Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit".

Ndryshimet e propozuara në rregullore publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=87>

Monedhat dixhitale – mundësi për pagesat ndërkufitare

Digital currencies inject new possibilities into cross-border payments

Justin Pugsley | September 20, 2022



There are good reasons for most countries to improve cross-border payment efficiencies, however that desire is complicated by technical and legal issues. But new forms of digital money potentially open up some interesting new channels.

Justin Pugsley

Artikulli përshkruan mundësinë që ofrohet për shumicën e vendeve për të përmirësuar efikasitetin e pagesave ndërkufitare, nga përdorimi i monedhave dixhitale. Megjithatë kjo çështje është e ndërlikuar dhe lidhet me çështjet teknike dhe ligjore. Format e reja të përdorimit të parave dixhitale potencialisht hapin disa kanale të reja pagesash.

—○○○—
**Global Risk
Regulator**

<https://www.globalriskregulator.com/>

—○○○—




Informacioni gjendet në:
<https://www.oecd.org/economic-outlook/september-2022>

OECD publikon raportin më të fundit vështrim ekonomik – Shtator 2022 “Perspektiva Ekonomike e Ndërmjetme”, që përmban analiza dhe projeksione për ekonominë botërore dhe të gjitha vendet e G20. Sipas këtij publikimi ekonomia botërore po paguan një çmim të lartë për luftën e paprovokuar, të pajustificueshme dhe të paligjshme të agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës. Ndikimet e pandemisë COVID-19 vazhdojnë ende dhe ndërkohë lufta po zvarrit rritjen ekonomike dhe po ushtron presion në rritjen e çmimeve, mbi të gjitha për ushqimet dhe energjinë. Prodhimi i Brendshëm Bruto në nivel global ngeci në tremujorin e dytë të 2022 dhe prodhimi ra në ekonomitë e vendeve të G20. Inflacioni i lartë po vazhdon për më shumë kohë se sa pritej. Në shumë ekonomi, inflacioni në gjysmën e parë të 2022 ishte në nivelin më të lartë që prej viteve '80. Me një kthesë negative të vërejtur në treguesit e fundit, perspektiva ekonomike globale është e zymtë. Katër janë gjetjet kryesore të raportit:

Ekonomia botërore po ngadalësohet më shumë se sa pritej

Real GDP growth projections for 2022 and 2023

Year-over-year, %



Source: OECD Economic Outlook, Interim Report September 2022

Pavarësisht rritjes së aktivitetit, pas rënies së ndjeshme të infeksioneve të COVID-19 në mbarë botën, rritja globale parashikohet të mbetet e kufizuar në gjysmën e dytë të 2022, përpara se të ngadalësohet më tej përgjatë viti 2023, në një rritje vjetore prej vetëm 2.2%. Krahasuar me parashikimet e OECD nga dhjetori 2021, përpara agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, GDP-ja globale tani parashikohet të jetë të paktën 2.8 trilion dollarë më e ulët në vitin 2023. Ka shumë kosto që ndikohen nga lufta e Rusisë, por kjo jep një kuptim të çmimit botëror të luftës për sa i përket prodhimit ekonomik.


Një faktor kyç që ngadalëson rritjen globale është shtrëngimi i përgjithshëm i politikës monetare, i nxitur nga tejkalimi më i madh se sa pritej i objektivave të inflacionit. Bllokimet e rrepta të lidhura me politikën zero të Kinës për COVID-19 kanë ndikuar gjithashtu në ekonominë kineze dhe atë globale. Mbylljet dhe dobësia e tregut të pronave po ngadalësojnë rritjen e Kinës në vetëm 3.2% në 2022.

Inflacioni është bërë më i përhapur

Inflation levels of consumer goods and services

% of consumer basket items

Inflation: ■ < 0% ■ 0% - 4% ■ > 4%



Data refers to July 2022 for United States and August 2022 otherwise.
Source: [OECD Economic Outlook, Interim Report September 2022](#)

Informacioni gjendet në:
<https://www.oecd.org/economic-outlook/september-2022>

Presionet inflacioniste po e zgjerojnë efektin e tyre përtej ushqimeve dhe energjisë duke u shtrirë pothuajse kudo. Bizneset në të gjithë ekonominë po kalojnë përmes kostove më të larta të energjisë, transportit dhe punës. Presionet më të gjera inflacioniste ishin të dukshme në Shtetet e Bashkuara në fillim të vitit 2022, dhe kjo tani po shihet edhe në zonën e euros dhe në një shkallë më të vogël në Japoni.


Më shumë se gjysma e zërave në indeksin e çmimeve tregojnë inflacion mbi 4% në Mbretërinë e Bashkuar, në Shtetet e Bashkuara dhe në zonën e euros, duke reflektuar një rritje të mprehtë krahasuar me një vit më parë dhe duke dyfishuar objektivat e tyre.

Ekonomia po ndjen kushtet e shtrënguara të tregut të punës – normat e papunësisë janë afër niveleve më të ulëta të 20 viteve, ndërkohë që shumë vende po rrisin pagat duke ndihmuar në zbutjen e humbjes së fuqisë blerëse dhe rritjes ekonomike. Megjithatë, kjo po i kontribuon gjithashtu edhe një inflacioni me bazë të gjerë. Rritja e pagave është forcuar në shumë vende, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar, por jo ende në zonën e euros.

Inflacioni do të zbutet, por do të mbetet në nivele të larta

Inflation is hitting the world economy

Year-over-year, %



Source: OECD Economic Outlook, Interim Report September 2022

Informacioni gjendet në:
<https://www.oecd.org/economic-outlook/september-2022>

Në shumicën e vendeve të G20, me kthimin e ciklit ekonomik global dhe shtrëngimin monetar nga shumica e bankave qendrore kryesore, inflacioni total parashikohet të arrijë kulmin në tremujorin aktual për shumicën e ekonomive kryesore. Ai pritet të bjerë në tremujorin e katërt si edhe përgjatë vitit 2023. Megjithatë, inflacioni vjetor në vitin 2023 do të mbetet më lart se objektivat e bankave qendrore, pothuajse kudo.

Shtetet e Bashkuara, të cilat filluan shtrëngimin e politikës monetare më herët, pritet të shohin më herët kthimin e inflacionit në objektiv, sesa në zonën e euros ose në Mbretërinë e Bashkuar. Në të kundërt, me rritjen e fundit të kostove të energjisë në ekonomi dhe me shtrëngimin e politikës monetare që filloi më vonë se në Shtetet e Bashkuara, si inflacioni total ashtu edhe ai bazë, parashikohet të mbeten të ngritura në pjesën më të madhe të Evropës.


Pamja e inflacionit në ekonomitë kryesore të tregjeve në zhvillim ndryshon shumë. Inflacioni është i ulët dhe i qëndrueshëm në Kinë, ndërkohë që në Brazil dhe Meksikë presionet ndaj inflacionit do të zvogëlohen, me hyrjen në fuqi të rritjes së normave të interesit. Normat shumë të larta të inflacionit në Turqi dhe Argjentinë parashikohen të vazhdojnë në vitin 2023, megjithëse disi më të ulëta se ato gjatë vitit 2022.

Reduktimi i kërkesës dhe diversifikimi i ofertës nevojiten për të shmangur mungesat e energjisë

Impact of further energy price hikes and disruptions

2/2 < >

% points difference from baseline projection



Assumes: global gas, oil and fertiliser prices to rise by 50%, 10% and 25% respectively; a 1 percentage point increase in the household saving rate; a 1 percentage point increase in the user cost of capital; and a temporary period of enforced rationing in industry use.
Source: OECD Economic Outlook, Interim Report September 2022

Në raportin “Perspektiva Ekonomike e Ndërmjetme” si rrezik shikohet se reduktimet në furnizimet me energji nga Rusia drejt Bashkimit Evropian rezultojnë shumë më shkatërruese sesa u parashikua në projeksione.

Nivelet e depozitimit të gazit në Bashkimit Evropian janë rritur në pothuajse 90% të kapacitetit. Por edhe në këtë nivel, mund të mos ketë magazinim të mjaftueshëm të gazit për të siguruar që kërkesa gjatë një dimri tipik. Mungesat mund të rriten ndjeshëm nëse furnizimet shtesë joruse nga jashtë Bashkimit Evropian dështojnë të materializohen siç pritej, ose nëse kërkesa për gaz është më e lartë për shkak të një dimri të ftohtë.

Pa diversifikim të mjaftueshëm të ofertës dhe reduktime të rregullta të kërkesës, mungesat mund të rrisin çmimet globale të energjisë, të godasin besimin dhe kushtet financiare dhe të kërkojnë racionim të përkohshëm të përdorimit të gazit nga bizneset. Të marra së bashku, këto goditje mund të ulin rritjen në ekonomitë evropiane me mbi 1¼ pikë përqindjeje në vitin 2023, në krahasim me bazën, dhe të rrisin inflacionin me mbi 1½ pikë përqindjeje. Kjo do të shtynte shumë vende evropiane në një recesion në vitin 2023. Për botën, inflacioni është rritur me mbi ½ pikë përqindjeje në 2023, ndërsa rritja ekonomike është reduktuar me pak nën ½ pikë përqindjeje.

Informacioni gjendet në:
<https://www.oecd.org/economic-outlook/september-2022>

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave statistikore të Agjencisë së Sigurimeve – AZOBiH në Bosnje-Hercegovinë, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, tregu i sigurimeve në vend arriti në 227.4 milionë euro (444.7 milionë BAM), duke arritur 9.4% më shumë në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Vëllimi i primeve të shkruara bruto përbëhej 21.4% nga sigurimet e Jetës, me 48.7 milionë euro dhe pjesa tjetër nga sigurimet e Jo-Jetës.

Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës ishin rreth 178.7 milionë euro. Nga ky vëllim 9.2% e primeve i përkiste linjave të sigurimit të pronës dhe 57.5% sigurimit motorik (Sigurimi Kasko dhe MTPL). Siguruesit e regjistruar në Federatën e Bosnje-Hercegovinës (FBiH) gjeneruan rreth 117.8 milionë euro të vëllimit të primeve të shkruara bruto totale të Jo-Jetës, dhe pjesa e mbetur prej 60.9 milionë euro u raportua nga siguruesit me bazë në Republikën Serbe të Bosnjës RS.

Totali i dëmeve të paguara u rrit me 18.7%, duke arritur në 98.2 milionë euro, nga të cilat 72.3 milionë euro u realizuan nga siguruesit e FBiH dhe 25.9 milionë euro - siguruesit e RS.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara, në fund të qershorit 2022 primet e shkruara bruto për siguruesit grekë anëtarë të Shoqatës Helenike të Shoqërive të Sigurimeve (HAIC) arritën në 2.14 miliardë euro, duke shënuar një rritje me 0.2% krahasuar me një vit më parë. Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 7.4% në terma vjetorë, duke arritur në 1.19 miliardë euro, nga të cilat 373 milionë euro – sigurime motorike TPL dhe 236.13 milionë euro – sigurimet e pronës.

Tregu i sigurimeve të Jetës u ul me 7.50% duke arritur në 955 milionë euro. Kjo rënie lidhet më shumë me dinamikën negative të raportuar nga policat tradicionale të sigurimit të Jetës, të cilat ranë me 14.40%.

Shifrat e tregut të publikuara nga HAIC përfshijnë informacione për 52 kompani sigurimesh, nga të cilat 17 ishin aktive në sigurimet e Jetës (dhe përbënin 99.9% të të dhënave të plota të segmentit të tregut për vitin 2021) dhe 45 ishin aktive në sigurimet e Jo-Jetës (94.5% të totalit të tregut).

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë, MNB, vëllimi i primeve të shkruara bruto në gjashtëmujorin e parë 2022 për siguruesit hungarezë u rrit me 14.81% në terma vjetore duke arritur në 785.43 miliardë HUF ose rreth 1.98 miliardë euro. Rritjen më të madhe e pati tregu i sigurimeve të Jetës, me 15.74% në vit duke arritur në 895 milionë euro, ndërsa primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 14% duke arritur në rreth 1.7 miliardë euro.

Për sa i përket dëmeve, dëmet e shkaktuara gjithsej (pagesat dhe ndryshimi i rezervave) u rritën me 20.96% në terma vjetorë duke arritur në 413.61 miliardë HUF. Dëmet në sigurimin e Jetës u rritën me 17%, ndërsa për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 27.73% duke arritur në 161.24 miliardë HUF.

Në fund të qershor, numri total i policave të sigurimit u rrit me 2.6% duke arritur në 14,873,655 kontrata. Kjo ka ardhur kryesisht nga një rritje prej 3.32% e numrit të kontratave të sigurimit të Jo-Jetës, ndërsa numri i kontratave të sigurimit të Jetës ra me 1.11%.

Në fund të qershorit 2022, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktive 22 sigurues: 4 shoqëri sigurimi të Jetës, 9 shoqëri sigurimi të Jo-Jetës dhe 9 shoqëri sigurimi me aktivitet të përbërë.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave gjashtëmujore të publikuara nga Agjencia lokale e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, ISA, tregu i sigurimeve në vend arriti në 54.9 milionë euro në fund të gjashtëmujorit të parë 2022, duke shënuar një rritje me 11.9% më shumë se një vit më parë.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës zinin 81.6% të tregut total të sigurimeve, ose rreth 44.8 milionë euro. Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 12.4%, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën me 9.2%.

Për sa i përket dëmeve, totali i pagesave arriti në 21 milionë euro, me rritje prej 0.9% në terma vjetorë. Dëmet e paguara për kontratat e sigurimit të Jetës u rritën me 3.1% duke arritur në 4.9 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 16 milionë euro me rritje 0.3% në terma vjetore.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Dhomës Polake të Sigurimeve (PIU), tregu i sigurimeve në vend e mbylli gjysmën e parë të 2022 me një rënie të lehtë të vëllimit të primeve të shkruara bruto - 0,5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimit të primeve të shkruara bruto arriti në 7.57 miliardë euro. Ndikim më të madh në treg pati segmenti i sigurimit të Jetës, i cili pësoi një rënie prej 8.3%.

Në përgjithësi, primet e sigurimit të Jetës arritën në 2.23 miliardë euro, ndërsa pesha e këtij segmenti në portofolin e tregut ra nga 32% në 29.5% në qershor 2022. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 3.14% në terma vjetorë, duke arritur në 5.33 miliardë euro.

Përsa i takon pagesave të dëmeve, në sigurimin e Jetës ato u rritën me 7.1%. Rritja më e madhe e pagesave kishte të bënte me sigurimin e investimeve dhe të kursimeve, e cila arriti në mbi 24.7% e shprehur në monedhën vendase. Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, dëmet e paguara për sigurimet motorike përbëjnë pjesën më të madhe të dëmeve. Megjithatë, ritmi më i lartë i rritjes u vu re edhe në linjat e sigurimit të pronës me rritje 57% më shumë se një vit më parë, e shprehur në monedhën evropiane.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, në gjashtëmuajorin e parë të 2022, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguroesit me bazë në Turqi u rrit 93% duke arritur në 91 miliardë TRY ose rreth 5.2 miliardë euro. E shprehur në monedhën euro dhe për shkak të zhvlerësimit të lirës turke TRY nga 1 euro = 10,3435 TRY (30 qershor 2021) në 1 euro = 17,4014 TRY (30 qershor 2022) norma e rritjes së primeve të shkruara bruto ishte 14.85%.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 97% në vit duke arritur në 77.7 miliardë TRY, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën me 73% në vit, duke arritur në 13.2 miliardë TRY. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, sipas statistikave të paraqitura nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, ishin aktive 63 siguroes.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al